



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

**Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë / /2025
Nr. Dok. 202501820/9

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave të zbatimit të projektit për mbulim me rrjet të kanalizimeve të disiplinimit të ujërave të ndotura në gjitha zonat që janë të klasifikuara si "njësi e zgjerimit ekstensiv me funksion kryesisht banim" në zbatim të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Planit të Detyruar Vendor të Bashkisë Lezhë, si dhe fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Bashkisë Lezhë për moskthim përgjigje ndaj kërkesave të institucionit të Avokatit të Popullit

BASHKISË

LEZHË

**Për dijeni: SHOQËRISË RAJONALE TË UJËSJELLËS KANALIZIME
LEZHË SH.A.**

LEZHË

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

TIRANË

Të nderuar!

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore, në mbrojtje të të drejtave, lirive themelore të shtetasve shqiptarë dhe atyre të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe interesave të tyre të ligjshme, ka marrë në administrim ankesë/kërkesë të grupit të banorëve të pallateve të ndërtuara nga firma "ULZA" sh.p.k. në lagjen SMT, Bashkia Lezhë, ndaj Ujësjiellës Kanalizime Lezhë sh.a. (UK Lezhë sh.a.) dhe Bashkisë Lezhë, lidhur me problematikën e mungesës së kanalizimeve për disiplinimin e ujërave të ndotura në ndërtimin e bërë.

Për ankuesit është e papranueshme që në ditët e sotme në ndërtimet e reja rregullimi i ujërave të ndotura, brenda qytetit, të bëhet nëpërmjet gropave septike, rasti konkret në Lezhë. Shqetësimi i tyre, sipas shpjegimeve, që sjellin në ankesë është se në janar të vitit 2018 në Lezhë zbatimi i programit “Infrastruktura Bashkiake I” nëpërmjet bashkëfinancimit nga shtetet palë si Zvicra, Gjermania dhe Bashkimi Evropian duhet të kishte sjellë përmirësime në rrjetin e ujësjellës kanalizime të qytetit. Duke qenë se pas përfundimit të punimeve nuk pati përmirësime të situatës, banorët kanë përcjellë ankesa të vazhdueshme që janë paraqitur pranë zyrave të UK Lezhë sh.a dhe Bashkisë Lezhë që vazhdojnë të mbeten të pa zgjidhura sa i përket ujërave të ndotura që dalin në rrugë dhe kthehen në burim infeksioni për të gjithë banorët.

Sa më sipër, ankuesit kanë kërkuar ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit për shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj çështjeje me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme.

Pas regjistrimit të kësaj ankese, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore si në aspektin formal ashtu edhe në atë substancial për t’u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në nenet 13, 17 shkronja “a” dhe 18, shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ka vendosur ta pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes¹.

Në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor, e konkretisht nenit 63, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: “*Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij*”, si dhe nenit 19 shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “*Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*”, në vijim të hetimit administrativ me qëllim sqarimin e fakteve e të rrethanave, i jemi drejtuar me disa shkresa Bashkisë Lezhë, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje.

Konkretisht, kemi dërguar shkresën e parë me nr. K3/ B11 – 2 prot., datë 12.06.2024, “Kërkesë për shpjegime”. Në kushtet kur ju nuk i jeni përgjigjur kërkesës së Avokatit të Popullit, iu jemi ridrejtuar sërish me shkresat nr. K3/B11 – 5 prot., datë 18.10.2024 dhe nr.K3/B11– 8 prot., datë 28.08.2024 “Kërkesë e përsëritur për shpjegime dhe dokumentacion”. Në zbatim të nenit 19, paragrafi 2, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme*” kemi kërkuar që informacioni i kërkuar të na vihet në dispozicion brenda një afati prej 10 ditësh nga marrja e kësaj shkrese. Por, ju bëjmë me dije se përsëri nuk është kthyer përgjigje, edhe pse ka kaluar afati i përcaktuar, si dhe çdo afat i arsyeshëm kohor.

¹ Neni 13 i Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur verën ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike*”

Në rrethanat e parashtruara sa sipër ju bëjmë me dije se kjo situatë përbën shkelje të hapur të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, si dhe të Kodit të Procedurave Administrative, duke mos zbatuar dhe cenuar rëndë parimin e respektimit të hierarkisë institucionale dhe bashkëpunimit ndërinstitutional. Mosdërgimi i përgjigjes së kërkuar ka sjellë si pasojë mostrajtimin e kësaj ankese brenda afatit ligjor dhe mungesën e korrektesës së institucionit tonë ndaj ankueses. Ky qëndrim i mbajtur nga organi juaj me institucionin tonë ka sjellë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave, lirive të shtetasve dhe interesave të tyre të ligjshme, si dhe në kthimin në kohë të përgjigjes ankuesve.

Ndërkohë kjo sjellje, cenon marrëdhëniet tona institucionale, si dhe dëmton imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit në publik. Mosdhënia e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, përbën shkelje të parimeve kushtetuese dhe ligjore. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të saj e ka ngritur në nivel kushtetues detyrimin e organeve të administratës shtetërore dhe funksionarëve publikë, për bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit dhe të drejtën e këtij të fundit për të kërkuar informacion e dokumentacion. Më konkretisht neni 63 parashikon se: *“1. Avokati i Popullit paraqet raport vjetor përpara Kuvendit. 2. Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t’i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme. 3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike. 4. Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”.*

Pra, parimi i bashkëpunimit në këtë rast është kushtetues dhe detyrues për të gjitha organet e administratës shtetërore, duke i detyruar ato t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, pa përjashtime. Rëndësia e këtij parimi konstatohet edhe në instrumentet ligjore që Kushtetuta i ka vënë në dispozicion Avokatit të Popullit, në rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut apo mosrespektimit të parimit të bashkëpunimit nga organet e administratës publike apo funksionarët publikë. Neni 63, pikat 1, 2 dhe 3, të Kushtetutës parashikojnë instrumente të tilla ligjore, në dispozicion të Avokatit të Popullit, si raportet vjetore dhe ato të veçanta, rekomandimet apo propozime për marrjen e masave administrative ndaj nëpunësve përgjegjës. Gjithashtu, edhe ligji nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, parashikon të drejtën e institucionit tonë për marrjen e masave administrative në rast të refuzimit për bashkëpunim nga organet e administratës publike apo nëpunësit e tyre. Në mënyrë eksplicite kjo është sanksionuar në nenin 22 të këtij ligji në të cilin është parashikuar se: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”.*

Parimi i bashkëpunimit mes organeve të administratës publike është sanksionuar si në Kodin e Procedurës Administrative ashtu dhe në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore”. Neni 3, i këtij të fundit parashikon se: *“Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të unitetit dhe hierarkisë;*

llogaridhënies; dekoncentrimin; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, evidencës dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucioneve të pavarura, për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar, në përputhje me ligjin". Duhet theksuar se Avokati i Popullit është institucion kushtetues, i cili ka rol "kontrollues" mbi veprimtarinë e organeve të administratës publike në lidhje me zbatimin e respektimin e të drejtave kushtetuese, duke ndihmuar individët që t'u krijohen shanse të barabarta, të mund të trajtohen si të barabartë në çdo marrëdhënie me administratën publike, përveç gjykatave.

Legjislatori ka parashikuar si veçori themelore të institucionit të Avokatit të Popullit, veç pavarësisë nga institucionet e tjera dhe nga çdo ndikim politik, edhe lehtësinë e kontaktimit, shpejtësinë dhe fleksibilitetin në kapjen e problemeve, si dhe mungesën e shpenzimeve, pasi veprimtaria e tij është pa pagesë. Mungesa e informacionit dhe dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme apo tej afatit të përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu, minon besimin e qytetarëve tek shteti dhe administrata shtetërore, ndërkohë që të gjitha përpjekjet në nivel evropian, por edhe atë të Këshillit të Evropës janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikator.

Megjithatë, krahas detyrimit të përgjithshëm për informim dhe transparencë që kanë organet publike përkundrejt palëve të treta, theksojmë se detyrimi për bashkëpunim me Avokatin e Popullit gjatë hetimit administrativ, veçse një detyrim i karakterit administrativ, është një detyrim kushtetues, për nga vetë specifika që ka ky organ publik. Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes. Po ashtu, sjellim në vëmendjen tuaj se bashkëpunimi dhe zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit është identifikuar si një nga elementët matës për vlerësimin e ecurisë së shoqërisë në kapitullin 23, përgjatë negociatave me BE.

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

Gjithë sa përshkruam më lart, theksojmë se në të njëjtat shkresa dërguar Bashkisë Lezhë i janë dërguar edhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë sh.a. (*SHRUK Lezhë sh.a.*) e cila ka kthyer përgjigje. Ndërkohë sa i përket Bashkisë Lezhë evidentohet lehtësisht neglizhenca apo mungesa e bashkëpunimit nga ky organ, duke ju referuar këtu afatit dhe datës kur kemi kërkuar informacion, që i përket datës 12.06.2024, ndërkohë akoma nuk kemi një përgjigje prej jush (10 muaj).

Në kthim përgjigjet e SHRUK Lezhë sh.a. me shkresat nr. 576/1 prot., datë 20.06.2024 dhe nr. 926/1 prot., datë 29.10.2024 sqarojnë se: “...Lagjja SMT ku është edhe pallati banorëve të ULZA sh.p.k, është jashtë rrezes së rrjetit publik të kanalizimeve të ujërave të ndotura të qytetit Lezhë, kjo zonë përjashtuar pallatet në fjalë është e banuar me shtëpi private, nuk ka patur asnjëherë dhe nuk ka rrjet publik të kanalizimeve të ujërave të ndotura, kjo do të thotë që e gjithë zona në fjalë funksionon me gropa septike. SHRUK Lezhë sh.a. është e njohur me këtë problematikë, ka kryer dhe po kryen në vazhdimësi shërbime të veçanta shitesë për gropën septike të ujërave të ndotura të këtij pallati... Qeveria Shqiptare, Organet e Qeverisjes Vendore dhe SHRUK Lezhë sh.a. kanë planifikuar ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura në zonat përreth qytetit Lezhë, ku përfshihet dhe zona e pallatit në fjalë, problem i cili do të marrë zgjidhje me realizimin dhe financimin e projekteve të reja në një periudhë afatshkurtër.”

Referuar këtij shpjegimi të dhënë nga SHRUK Lezhë sh.a. , ajo çfarë kemi kërkuar të marrë përgjigje, thelbësisht i referohej arsyes dhe paqartësisë se pse për këtë objekt është pranuar dhe aprovuar e gjithë dosja për realizimin e tij me destinacion përdorim banimi, ku vendnodhja e tij është në një zonë ku nuk ka rrjet të disiplinimit të ujërave të ndotura, por ka rrjetin e ujit të pijshëm, rrjete të cilat administrohen nga UK Lezhë sh.a. . Duke qenë se kjo përgjigje është e pjesshme dhe nuk qartëson në kuadër më të plotë shpjegimet që konsiderohen të domosdoshme për trajtimin e rastit të paraqitur pranë institucionit tonë, ju kemi drejtuar pyetjet për të cilat kemi kërkuar dërgimin e shpjegimeve, lidhur me:

- Cila është praktika, strategjia, e adaptuar nga Bashkia Lezhë për miratimin e lejeve të ndërtimit objekt për banim?
- Në dosjen e aplikimit që duhet të dorëzojnë subjektet e interesuara a duhet të përfshihet detyrimisht dhe parashikimi i futjes për t’u ndërlidhur në rrjetin ekzistues të shërbimeve publike si ajo e UK Lezhë, apo mjafton projekti mbi objektin vetëm si ndërtesë pa parashikuar shërbimet e largimit të ujërave të ndotura dhe të furnizimi me ujë të pijshëm?
- Cilat janë planet për zbatim të planit të detyrueshëm vendor për zgjerimin e rrjetit dhe futjes në rrjetin e disiplinimit të ujërave të ndotura dhe rrjetin e ujit të pijshëm objektet e banimit ekzistuese të cilat trajtohen me gropa septike dhe objekteve që do të ndërtohen në të ardhmen?
- Çdo informacion/dokumentacion që ka të bëjë me këtë çështje.

Në këtë prizëm referuar dokumentit “Plani i Detyruar Vendor për zonat e dëmtuara pikësore, 42 banesa individuale”² i miratuar nga Kryetari i Bashkisë Lezhë në maj të vitit 2021, evidentoheshin objektivat kryesorë të zhvillimit, sfidat rreziqet dhe mundësitë me të cilin mund të përballej territori.

Më konkretisht, në pikën 3.1.1³ Sistemi Urban, për “Territorin urban” i cili është hapësira gjeografike e vazhdueshme, e ndërtuar nga aktiviteti njerëzor për të cilën si politika janë

²<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=6398&token=0f0f679ac38aab30167775948709bbac7013eb91>

³ Faqe 19-20 e Planit të Detyruar Vendor për zonat e dëmtuara pikësore, 42 banesa individuale

parashikuar zhvillimi policentrik, densifikimi, gjithëpërfshirja. Ky sistem urban do të zhvillohej në parimet dhe objektivat strategjike mbi të cilat do të zbatohet zhvillimi i Sistemit Urban, SUB. 12 “Promovimi i programeve dhe projekteve për rinovimin urban të zonave dhe të vendbanimeve që gjenden në kushte të degradimit fizik, social dhe mjedisor për përmirësimin e efikasitetit energjetik dhe uljen ndaj riskut sizmik. Ndarja e hierarkisë së qendrave urbane bëhet në: -Qendrat primare (në zonat e banuara me popullsi të stabilizuar dhe shërbime bazike të karakterit infrastrukturor si elemente të hierarkisë lokale; - Qendrat e specializuara (që do të zhvillohen në përputhje me potencialet e tyre dhe karakteristikat specifike të karakterit ekonomik.).

Në pikën 5.2.3⁴ të këtij dokumenti bëhet përshkrimi i Rrjetit inxhinierik ku përmendet se “Konstatohet që në rrjetin e ujësjellës-kanalizime në qytetin e Lezhës dhe Shëngjinit ka një investim të miratuar dhe është në fazën përmbyllëse të saj...Menaxhimi i resurseve të burimeve natyrore dhe rezervave ujore është i domosdoshëm. Modernizimi dhe zbatimi i metodave bashkëkohore, si vendosja e matësive inteligjente të ujit, instalimi i pajisjeve efikase të energjisë, telemanaxhimit, krijimi i bazës së të dhënave dixhitale. Është propozuar gjithashtu përmirësimin dhe modernizimi i rrjetit në të gjitha qendrat e banuara të bashkisë.” Më tej përshkruhet Menaxhimi i integruar i ujërave të zeza që do të thotë: - Mbajtja në efikasitet e ITUP-se për t’i shërbyer zonës urbane të Bashkisë; - Ndërtimi dhe plotësimi i rrjetit të kanalizimeve në zonën urbane dhe në të gjitha njësitë administrative të Bashkive. Mundësia për të ndërtuar një rrjet të ndarë, në të cilin do të ndahen ujërat e shirave nga ato të përdorura ose një rrjet të unifikuar ku përfshihen të dyja sistemet. Rrjeti mund të jetë ose gravitacional ose me ngritje mekanike në varësi të kërkesave që lindin nga morfologjia e zonës dhe studimit të saj. Një kosto e përafërt e ndërtimit të këtyre impianteve është 60 euro/banorë⁵.

Paralelisht në skemat e Njësive strukturore me kodin KO-UB-xxx ku bën pjesë edhe zona e lagjes SMT, përgjithësisht përshkruhen si: “Njësi e zgjerimit ekstensiv me funksion kryesisht banim. Propozohet ruajtja e këtij përdorimi. Çdo ndërhyrje duhet të garantojë përmirësimin e hapësirave publike dhe cilësinë e mjedisit të ndërtuar në përputhje me karakterin lokal. Propozohet konsolidim, si proces i zhvillimit të territorit. Lejohen ndërtime/ zhvillime për banim dhe shërbime tregtare dhe publike.”⁶.

Për këtë, Avokati i Popullit ju përgëzon që ka plan dhe njeh bërjen e planit, por lind nevoja për të kuptuar më qartë shtrirjen dhe zbatimin e këtij plani.

⁴ Faqe 32 e Planit të Detyruar Vendor për zonat e dëmtuara pikësore, 42 banesa individuale

⁵ E njëjta e dhënë është edhe në dukumentin Plan i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Lezhë, Plan i Zhvillimit të Territorit, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 6, datë 16.10.2017 <https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=3375&token=1497714ef5780b0afc4766300c94626e53c8672d> dhe në nenin 76 “Sistemitmi i kanalizimeve dhe pastrimi i ujërave të ndotura urbane”, të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Lezhë, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 6, datë 16.10.2017 <https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=3903&token=4c1efb6c968c8546c75b4c1aabe37e244b439483>

⁶ Faqe 469-477 e Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Lezhë, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 6, datë 16.10.2017

Gjithashtu në nenin 22 “Ndërtimet/zhvillimet të lejuara” parashikohet: “ Të gjitha ndërtimet në territor duhet të jenë në përputhje me kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës sipas përcaktimeve në këtë rregullore, duke i kushtuar rëndësi të posaçme: parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm; shërbimeve publike (të duhurave dhe shpërndarjes adekuate të tyre); higjienës dhe shëndetit publik; ruajtjes së tipareve dhe burimeve natyrore; mbrojtjes nga ndotja mjedisore, rreziqet natyrore dhe rrezikut teknologjik.

Më tej neni 41 “Transferimi i së drejtës për zhvillim – TDZH”, në paragrafin 1 dhe 2 të tij parashikon se: *TDZH është një teknikë e menaxhimit të përdorimit të tokës që transferon zhvillimin nga një zonë ku Bashkia dëshiron të ketë më pak zhvillim tek njësi/ zona ku ajo synon të ketë më shumë zhvillim, në përputhje me PPV-në. Kuadri ligjor për planifikimin e territorit kërkon që PPV-ja, të përfshijë: mbrojtjen e burimeve natyrore kulturore dhe historike, sigurimin e infrastrukturës së përshtatshme për nxitjen e investimeve, marrjen e vlerës së rritur të tokës që shoqëria e krijon atë, si dhe nxitjen e zhvillimit të balancuar rajonal.*

Sa mësipër, kuptohet se Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Lezhë dhe Plani i Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Lezhë, të miratuar që në vitin 2017, dhe pas dy rishikimeve që i janë bërë planit një në vitin 2020 dhe i fundit në vitin 2023⁷, është një sfidë e cila është pranuar të zbatohet me qëllim përmirësimin e jetesës dhe përditshmërisë së banorëve, në aspektin infrastrukturor, të territorit nën juridiksionin e Bashkisë Lezhë. Gjithashtu, thelbësor është edhe niveli i zbatueshmërisë në raport me kapacitetin financiar që organi i vetëqeverisjes vendore ka, por që ky raport të jetë i drejtë dhe i realizueshëm katërçipërisht brenda afateve të parashikuara, ka nevojë për mbështetje dhe financim nga organet qendrore përgjegjëse apo forma të tjera bashkëfinancimi, në rastet kur vetë njësia e vetëqeverisjes vendore është në pamundësi konkretizimi në afate të paracaktuara.

Hyrja në fuqi e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, më 1 prill 2009, shënoi një fazë të re më të avancuar të marrëdhënieve të Shqipërisë me BE-në. Më 28 prill 2009, Shqipëria paraqiti në Këshillin e BE-së kërkesën për anëtarësim. Më 27 qershor 2014, Shqipëria mori statusin e vendit kandidat si rrjedhojë Shqipëria duhej të përmbushte përpara fillimit të negociatave të anëtarësimit pesë prioritetet kryesore (administrata publike, sundimi i ligjit, lufta kundër korrupsionit, krimi i organizuar, të drejtat themelore).

Në realizimin e këtyre prioritetëve, një ndër hapat që e shoqëroi atë, ishte Reforma Administrativo-Territoriale, ndryshe e përkthyer me ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të përditësuar. Në nenin 3 të këtij ligji parashikohet: “*Misioni i vetëqeverisjes vendore*” Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet: a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive; b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e

⁷ <https://planifikimi.gov.al/index.php?id=732&L=0>

vetëqeverisjes vendore; d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; dh)nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithë-përfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Theksohet se aktualizimi i Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar në vitin 2017, është i ndarë në faza planesh të cilat janë me periudha realizimi afat –shkurtër; afat mesëm dhe afatgjatë, të cilat arrijnë deri në 10 vite.

Duke iu referuar problematikës së hasur, në respektim të afateve procedurale të kthimit të përgjigjes, institucioni i Avokatit të Popullit kërkon ushtrim të kompetencave dhe përmbushjes së detyrave funksionale, marrjen e masave disiplinore, për mosveprim në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore në fuqi, për punonjësit përgjegjës të ngarkuar për kthim të përgjigjes së kërkesave të institucionit të Avokatit të Popullit.

Në përmbushje të angazhimeve të marra në bashkëpunim me organet publike qendrore, organet e vetëqeverisjes vendore të cilat janë përgjegjëse, Bashkia Lezhë dhe Njësitë Administrative nën juridiksionin e saj, duhet të tregojnë angazhimin e tyre me të gjitha kapacitetet si dhe të kërkojnë alternativat për arritjen e objektivave të caktuara.

Për këto arsye, bazuar në nenin 22/1, të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”,*

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave për jetësimin e projekteve dhe angazhimeve të marra nga Bashkia Lezhë në përputhje me përmirësimin e jetës së banorëve dhe qytetarëve të saj, në zhvillimin territorial të saj.
- Marrjen e masave për hartimin e një projekti të mirëfilltë të rrjetit të kanalizimeve me perspektivë përfshirjen e zonave në zhvillim edhe për dekadat e ardhshme.
- Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e detyrimit ligjor, për dhënien e informacionit Avokatit të Popullit.
- Fillimin e procedurës administrative, për evidentimin e punonjësve përkatës përgjegjës të Bashkisë Lezhë, lidhur me mospërmbushjen e detyrimit ligjor, për t'i kthyer përgjigje kërkesave të Avokatit të Popullit, për dërgimin e informacionit të kërkuar, si dhe marrjen e masave administrative e disiplinore ndaj tyre.

- Marrjen e masave organizative që kjo shkelje të mos përsëritet në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj kësaj kërkesë si dhe masat disiplinore që do të merrni na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh, në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “ Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

KOMISIONERE

Erinda MELI